

P.nr.1769/17

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm-Penal**, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me zyratën ligjore Dafina Ymeri në çështjen penale kundër të pandehurit A.J. nga P., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4652/16 të datës 11.04.2017, jashtë seancës, me datë 10.04.2018, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë- departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4652/16 të datës 11.04.2017, për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor,

Andaj gjykata konformë nenit 495 të KPPK-së, jep:

**URDHËR NDËSHKIMOR****I akuzuari;**

**A.J.**, i ati **L.**, i lindur mëdt:..., në fshatin **S.**, me vendbanim në **P.** në Rr. "S.Z." nr..., Laxhja "D.", me nr. personal ..., shqiptar, - shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR****Sepse,**

Me datën 08.08.2016, rreth orës 15:15, afërsi të kompleksit "D." në **P.** në rrugën Ferizaj-Mitrovicë i pandehuri **A.J.**, derisa ka qenë duke drejtuar automjetin e tipit "VW", me ngjyrë Bardhë me targa të regjistrimit ..., ka shkelur Ligjin mbi trafikun publik dhe ka rrezikuar jetën e njerëzve, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 54 të Ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor, nga pakujdesia duke mos mbajtur distancën e duhur e godet në pjesën e mbrapme automjetin e tipit "VW" me ngjyrë të bardhë, me targa të regjistrimit ..., i cili nga goditja e pësuar me pjesën e përparme e godet në pjesën e mbrapme automjetin e tipit "VW" me ngjyrë të bardhë, me targa të regjistrimit ..., me ç'rast lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin pësojnë të dëmtuarit **S.K.**, **M.T.** dhe **S.S.**

**-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton

**DËNIMIN ME GJOBË**

Nëshumë prej **200(dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mundë ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, deri në datën 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

**Obligohet:** i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t'ia kompensoj shumën prej **40.88** euro për ekspertizën e komunikacionit, shumën prej **50** euro te ekspertizës mjeko-ligjore, si dhe në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej **30** euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

**Tëdëmtuarit** – S.K. nga P. rruga “Sh.I.” Hyrja nr.... nr...., M.T. nga M. dhe S.S. nga V., lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.4652/16 të datës 11.04.2017, kundër A.J.nga P.,për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuari sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i çështjes, Gjykatës i ka propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhrit Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërin e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve të cilat vërtetojnë faktin se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe vendosi që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Mendimi i ekspertit mjeko-ligjor edatës 09.10.2016, mendimi i ekspertit të komunikacionit edatës 05.09.2016, si dhe të shikohen skica dhe fotografit e vendit të ngjarjes, janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6lidhur me par.1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, palët e dëmtuarajanë udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i përgjithshëm-Penal  
P.nr.1769/17, të dt. 10.04.2018

**Zyrtare Ligjore**  
Dafina Ymeri

**Gjyqtari,**  
Kujtim Krasniqi

**KËSHILLA JURIDIKE;**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.